



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 228402, FAX: +4 223981

VENDIM

Nr. 19 datë 13.07.2016

"Për hapjen e një programi studimi të ciklit të dytë "Master Profesional" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja"

Bazuar në nenin 3 pika 2 gërma b), neni 7 pika 2 gërma dh), neni 18 pika 5, neni 23 pika 1, neni 25 pika 7, neni 35 pika 1, neni 39 pika 1 gërma dh), neni 42 pika 7, neni 69 pika 1, neni 49 pika 2, neni 70 pika 3, neni 71 pika 1, neni 75 pika 6, neni 91 pika 3 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 19 pika 1, neni 49 pika 2 të Statutit të UT-së, mbështetur në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të përcjellë me shkresën nr. 943 prot., datë 07.07.2016 (fakultet koordinator), si dhe të Fakultetit të Ekonomisë dhe atë të Historisë dhe Filologjisë, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 13.07.2016

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" në Gjuhë, Komunikim dhe Turizëm me profil "Guidë turisitike dhe mediator kulturor", në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.
2. Miratimin e formës dhe përmbajtjen e diplomës "Master Profesional" në Gjuhë, Komunikim dhe Turizëm me profil "Guidë turisitike dhe mediator kulturor".
3. Të përcillet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ky vendim së bashku me praktikën e plotë me qëllim miratimin dhe hapjen e këtij programi studimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

MYNYR KONI